



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 364

Datë: 11.08.2022

Në bazë të nenit 8, nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17, nenit 24, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008", nenit 2 paragrafi 2.1,2.3, të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/03 qershor 2008", nenit 8 paragrafi 9 të Rregullores Nr.02/236 datë:13.05.2022 për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, në bazë të nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 shkronja (b), nenit 40, të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur, me datë: 09.08.2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet vendimi për mbështetje financiare, për fëmijët e Familjes Sopaj nga fshati Jançisht të lënduar si pasojë e aksidentit rrugor.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi fëmijëve të Familjes Sopaj nga fshati Jançisht, të lënduar si pasojë e aksidentit në komunikacion rrugor dhe që kanë humbur të dy prindërit e tyre në aksidentin e komunikacionit, ju ndahen mjetet financiare në shumën prej 5.000.00€ (pesëmijë euro), në emër të ndihmës momentale për trajtim shëndetësor.
 - 2.1. Mjetet në shumën prej 5.000.00€ (pesëmijë euro) ndahen nga kategoria e subvencioneve-blloku kodues 10/625/73800/200/00000/0721, programi i shëndetësisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi, sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

Vendimi ju dërgohet
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.





PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 11/08/2022
PRILJENO:
Nr.No.Br. 04/767



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Kuvendi Komunal Malishevë

DATË/A:	11/08/2022
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
ACC:	Bora Duli – Zyrtare e Lartë Ligjore
NGA/OD/FROM:	Blerim Thaçi-Drejtor për Ekonomi,Financa dhe Buxhet
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
KOPJE:	Arkivit të Komunës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për masën monetare për mjetet e ndara nga mbledhja e Kuvendit më datën 09.08.2022

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se lidhur me vendimet e Kuvendit të Komunës të miratuara me datën, 09.08.2022;

1. Vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 5.000,00€, për fëmijët e familjes Sopaj nga fshati Janqist të lënduar në aksidentin në komunikacionin rrugor, dhe që i kanë humbur të dy prindërit në aksidentin rrugor.
2. Vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 5.000,00€ për trajtim shëndetësor për zj.Minire Helashni nga fshati Banjë.
3. Vendimi për mbështetje financiare në shumën prej 5.000,00€ për trajtim shëndetësor për z. Pajtim F.Krasniqi nga fshati Tërpezë.

Mjetet e ndara nga Kuvendi i Komunës, merren nga kategoria e subvencionëve, blloku kodues Nr. 10/625/73800/200/00000/0721, nga programi i shëndetësisë.

Drejtorja per buxhet dhe financa ju konfirmojm se ka mas monetare-buxhetore.

Më Respekt!